

VENDIM
Nr.627, datë 11.6.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 27 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës kombëtare të profesioneve, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Lista kombëtare e profesioneve të zbatohet nga ministratë e institucionet e tjera qendrore, organet e pushtetit vendor dhe personat juridikë e fizikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike.
 3. Lista kombëtare e profesioneve të zbatohet në këto veprimtari:
 - a) Mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore në fushën e profesioneve;
 - b) Regjistrimin e kërkuesit të punës, të përfituesit të pagesës së papunësisë, të vendit të lirë të punës dhe të të punësuarit;
 - c) Ndërmjetësimin për punë e profesion të kërkuesit të punës;
 - ç) Arsimin dhe formimin profesional të kërkuesit të punës ose të të punësuarit;
 - d) Migracionin e kërkuesit të punës, shqiptar ose të huaj, në shtete të tjera dhe në Shqipëri;
 - dh) Strukturimin e pagave në veprimtarinë shtetërore dhe private;
 - e) Veprimtaritë e tjera, që miratohen nga Këshilli i Ministrave.
 4. Lista kombëtare e profesioneve ndryshon dhe përshtatet, në bazë të rekomandimeve të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional, në përputhje me kushtet e reja të zhvillimit dhe në bashkëpunim me partnerët socialë.
 5. Nomenklatura e profesioneve përbëhet nga:
 - a) emërtimi i profesionit;
 - b) kodi numerik i profesionit;
 - c) përshkrimi i profesionit.
 6. Kodi numerik i profesionit është një bashkësi me 6 shifra, të cilat tregojnë, përkatësisht,:
 - a) Shifra e parë “Grupin e profesionit”;
 - b) Shifra e dytë “Nëngrupin e profesionit”;
 - c) Shifrat e tretë dhe e katërt, së bashku, “Profesionin”;
 - ç) Shifrat e pestë dhe e gjashtë, së bashku, “Punësimin”.
 7. Vendimi nr.272, datë 8.5.1995 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e nomenklaturës së profesioneve dhe punësimeve”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha